



Pranuar / Dorezuar Pimljeño/Prodato Received / Delivery	28 - 10 2022	viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Ni Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTHOK	6523 / 2022		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.763/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.763/2022 të datës 02.09.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.10.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.763/2022 e datës 02.09.2022 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi me datë 02.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5112/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.763/2022 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.08/2022 të datës 05.08.2022 me të cilin vendim kandidati i propozuar për përzgjedhje është përzgjedhur për emërim në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.08.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë, të Udhëheqësja e Personelit në Sekretariatit të Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila me datë 13.10.2022 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës për këtë çështje në procedurë.

Kryetari i Këshillit, me Vendimin VK.nr.124/2022 të datës 14.10.2022 ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) dite punë në pajtim me nenin 17 paragrafin 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 5112/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.763/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin e datës 15.08.2022 me nr. Ref. AGJ 2040/22 rasti nr.KI10/22 i Gjykatës Kushtetuese; Vendimin Nr.08/2022 të datës 05.08.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 16.08.2022 njoftim për vendimin nga për ankuesin; E-mail i datës 15.08.2022 njoftim nga për ankuesin; E-mail i datës 21.07.2022 njoftim ng për ankuesin; Njoftim i datës 29.07.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të KPMSHCK; Njoftim i datës 18.07.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore në KPMSHCK; Vendim Anr.393/2022 i datës 14.06.2022 i nxjerrë nga KPMSHCK; Autorizim nr.925/2020 i datës 27.10.2020 lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm në MPB; Akt emërim nr.43 i datës 13.07.2022; Diplomë Nr.683 e datës 10.07.2014, me vërtetim nga Noteri me numër LRP Nr.2638/2014; Akt emërim i datës 08.07.2013; Akt emërim i datës 25.06.2012; Vërtetim i datës 30.01.2007 lëshuar nga Oda e Avokateve të Kosovës; Certifikatë e datës 23.09.2019 prej ½ faqe; Vendim nr.3493 i datës 31.07.2009 lëshuar nga MAP; Kontratë e marrëdhënies së punës, numër i postit: 3/DIEKP e datës 20.06.2011; Vendim i datës 02.07.2021 me nr.553 lëshuar nga MPB; Kontratë e marrëdhënies së punës, numër i postit: 3/DRNOJQ e datës 17.08.2009; Kontratë e marrëdhënies së punës, numër i postit: 2/DL e datës 01.05.2010; Vendimi VK.nr.124/2022 i datës 14.10.2022 për vazhdim të afatit; Përgjigje në ankesë nr. protokolli 6165/2022 i datës 13.10.2022, Konkursi i datës 01.06.2022; Formulari për listën e ngushtë i datës 11.07.2022 për ankuesin, prej 1/4 faqe pasqyra e tabelës; Formulari për listën e ngushtë i datës 11.07.2022 për kandidatin e përzgjedhur B.S, prej 1/4 pasqyra e tabelës; Rezultati i procedurës përfundimtare për pozitën: Sekretar i Përgjithshëm në KPMSHCK(LZP), i nxjerrë nga ëeb faqja: <https://sp.kosovoselektion.org/corrent>, Ambasadës Britanike sipas Memorandumit të Mirëkuptimit, Lista e kandidatëve fitues e datës 01.08.2022 e lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të KPMSHCK; Konfirmimi për përfundimin e konkursit i nxjerrë nga sistemi elektronik SIMBNJ-së; Vendim i datës 24.06.2022 për ndryshim të komisionit të pranimit; Vendimi nr. 06/2022 i datës 31.05.2022 për themelimin e komisionit të pranimit; E-mail i datës 21.07.2022 udhëzim për kandidatët; E-mail i datës 19.07.2022 verifikimi paraprak; Njoftim i datës 18.07.2022 verifikimi paraprak; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 28.07.2022; Vendimi i datës 28.07.2022 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve; Lista e aplikacioneve e nxjerrë nga sistemi elektronik SIMBNJ-së dhe kandidatet e refuzuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar se ankesa A.nr.763/2022 e datës 02.09.2022 e parashtruar nga ankuesi *është e palejuar, SEPSE:*

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me datë 01.06.2022 ka publikuar konkursin me numër RN00009150 për pozitën e punës Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 01.07.2022 deri me datë 08.07.2022.

Procedura e rekrutimit për pozitën e punës Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka qenë e monitoruar nga projekti i Ambasadës Britanike në Kosovë.

Komisioni i Pranimit, i themeluar me Vendim Nr.06/2022 të datës 31.05.2022, plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr.07/2022 të datës 24.06.2022, me datë 29.07.2022 ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatet e suksesshëm dhe rrjedhimisht me datë 02.08.2022 ka dorëzuar listën e kandidateve fitues të titullari i institucionit, respektivisht Kryetari i Këshillit.

Sipas Komisionit të Pranimit, kandidatet fitues për pozitën e punës Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ishin:

87.8 pikë, dhe – 80.13 pikë, ndërsa, sipas projektit të Ambasadës Britanike, kandidatet fitues, ishin: – 79.59 pikë; dhe – 70.34 pikë.

Rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës të dy kandidatet e lartcekur kanë kaluar pragun minimal prej 70% të pikëve dhe të njëjtit konsiderohen kandidatet të suksesshëm, sipas dispozitave të nenit 40 paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kryetari i Këshillit, në mbledhjen e njëmbëdhjetë (11) të Këshillit, të mbajtur me datë 02.08.2022, ka njoftuar anëtarët e Këshillit lidhur me ecurinë e procesit dhe rrjedhimisht listën e kandidateve fitues të propozuar nga Komisioni i Pranimit dhe ekspertet e projektit të Ambasadës Britanike. Rrjedhimisht, pas diskutimeve dhe vlerësimit të këtij procesi si të rregullt, në mënyrë unanime është vendosur që Kryetari i Këshillit në mbështetje të nenit 13 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 42 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, të përzgjedh kandidatin për pozitën e punës Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Përcaktimi për përzgjedhjen e kandidatit është bërë duke marr parasysh përvojën e tij menaxheriale në pozita drejtuese në kuadër të Shërbimit Civil të Kosovës, me theks të veçantë përvojën e tij në një institucion që për mandat ka trajtimin dhe zgjedhjen e ankesave lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe çasjen në dokumente publike, përvojë kjo e cila ishte vlerësuar se do t'i ndihmojë Këshillit në adresimin e sfidave dhe në përmbushjen e detyrave kryesore të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 40 paragrafi 8 përcaktohet se: *Jo më shumë se tre (3) kandidatët e vlerësuar, nga komisioni i pranimit, me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Me emrat e kandidatëve fitues njoftohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ata bëhen publik nga Njësia e pranimit në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ-së dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Kandidatët që nuk janë fitues njoftohen personalisht dhe kanë të drejtën e ankimit në KPMSHCK, në afat kohor 8 dite kalendarike.*

Në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit konstaton se kandidatët që nuk janë fitues, respektivisht kandidatet të cilët nuk kanë kaluar pragun e kalueshmërisë prej 70% të pikëve, kanë të

drejtën e ankimit në Këshill, në afatin kohor prej tetë (8) ditësh, ndërsa kandidatet fitues të cilët kanë kaluar 70% të pikëve, mund të parashtrojnë ankesë në Këshill, vetëm në rast se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk shprehet brenda afatit ligjor prej 10 ditësh lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues, apo nëse procedura e nisur e rekrutimit për arsye të ndryshme ndërpritet nga organi përkatës pa përzgjedhjen e njërit nga kandidatet fitues.

Andaj, duke marr parasysh konstatimin se ankuesi është kandidat fitues, për faktin se i njëjti ka kaluar pragun e kalueshmërisë prej 70% dhe është i propozuar për përzgjedhje përfundimtare, ashtu sikurse edhe kandidati i përzgjedhur Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa A.nr.763/2022 e datës 02.09.2022 është e palejueshme sepse kandidatet fitues, në rastin konkret ankuesi nuk ka mund të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, pasi që procedura e përzgjedhjes është përmbyllur me sukses, brenda afatit të përcaktuar ligjor prej dhjetë (10) ditësh, dhe përzgjedhja e kandidatit të suksesshëm është bërë përmes ushtrimit të diskrecionit nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, respektivisht pas marrjes së pëlqimit në mbledhjen e Këshillit, duke ofruar paraprakisht një arsyetim me shkrim siç përcaktohet me nenin 42 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA ME NUMËR A.nr.763/2022**

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në KPMSHCK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.